

RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM)



Fabrikë për prodhimin dhe përpunimin e detergjentëve të lëngshëm, siç janë detergjenti për enë, detergjenti për rroba, shampo, si dhe produkteve të pastrimit, preparateve për shkëlqim, sapunëve, dezinfektuesve, antiseptikëve dhe pesticideve

UBT SH.P. K

Emri/Mbiemri i Aplikuesit:

Edmond Hajrizi

.....

Hartuesi i Raportit:

Besa Veseli

.....

Prishtinë 2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Zivotne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planing and Infrstructure

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08L/181 dhe Udhëzimi Administrativ për
Licencim të Hartuesëve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, Ministri i MMPHI
lëshon:

Nr. i licencës: 36/19/24

LICENCË

Besa VESELI
Doktor i Shkencave Mjedisore

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM- së

Data e vlefshmërisë:
12.08.2024— 11.08.2029
Prishtinë


z. Liburn Aliu
Ministër i MMPHI



Të dhënat e pronarit të projektit

Investitori: Edmond Hajrizi

Adresa: Rr. Ibrahim Rugova, nr. P.n., Zona Ekonomike, Konjuh - Lipjan

Nr. Telefonit: +38344284988

Email: ehajrizi@ubt-uni.net

Hartuese e raportit: Besa Veseli (Eksperte e licencuar nga MMPHI për hartimin e raporteve të VNM-së)

Adresa: Rruga “Murat Hasani” Zhabarë i Poshtëm, Nr.9 - Mitrovicë

Nr. Telefonit: +38344713123

Email: besaveselii@gmail.com

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	5
2.	BAZA LIGJORE DHE INSTUTICIONALE	7
3.	METODOLOGJIA E PUNËS	8
	Informatat themelore mbi:	8
	Vlerësimi i ndikimeve sipas kritereve në vijim:	8
4.	PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROJEKTIT DHE KUSHTEVE MJEDISORE	9
	<i>Pozita gjeografike e lokacionit</i>	9
	<i>Popullsia</i>	11
	<i>Topografia</i>	12
	<i>Biodiversiteti</i>	13
	<i>Ajri</i>	15
	<i>Resurset ujore</i>	17
	Infrastruktura ekzistuese	19
	Efektet vizuale (peizazhi)	19
	Zhurma	19
5.	PËRSHKRIMI I PROCESIT TEKNIK	21
6.	PËRSHKRIMI I PROCESIT TEKNOLOGJIK, PAJIMET	21
	Përshkrimi dhe karakteristikat kryesore të procesit të prodhimit	21
		27
7.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	28
	Ndikimet në tokë	29
	Ndikimet në florë dhe faunë	30
	Trajtimi dhe deponimi i mbeturinave	30
	Zhurma	30
8.	PËSHKRIMI I MASAVE PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS	31
9.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI	35
	<i>Monitorimi</i>	35
	<i>Qëllimi i Monitorimit</i>	35
	<i>Autoriteti përgjegjës</i>	35
	<i>Duhet të aplikohen metoda të inspektimit si më poshtë:</i>	35
10.	PËRMbledhje JOTEKNIKE E INFORMATAVE TË OFRUARA	36
11.	LITERATURA	37
12.	SHTOJCA	37

1. HYRJE

Ky dokument paraqet një raport të përmblëdhur të Vlerësimit të Ndikimeve në Mjedis, për UBT SH.P.K, Fabrikë për prodhimin dhe përpunimin e detergjentëve të lëngshëm, siç janë detergjenti për enë, detergjenti për rroba, shampo, si dhe produkteve të pastrimit, preparateve për shkëlqim, sapunëve, dezinfektuesve, antiseptikëve dhe pesticideve.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për për UBT SH.P.K, Lipjan me pronar Edmond Hajrizi paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor në objektin egzistues në parcelën P-71409036-00164-28 në zonën kadastrale Konjuh – Komuna Lipjan (Pjesa Hartografike e paraqitur me poshtë):



Raporti është përgaditur sipas kërkesave të kornizës ligjore mjedisore të Kosovës vecanërisht sipas Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis – Ligji Nr.08/L-181.

- Gjendjen e përgjithshme në dhe rreth lokacionit të objektit;

- Kushtet mjedisore ekzistuese;
- Përshkrimi teknik i projektit;
- Ndikimet e mundshme të projektit në mjedis;
- Identifikimi i masave për zbutjen e këtyre ndikimeve dhe
- Ndërmarrja e masave adekuate për evitimin apo minimizimin e ndikimeve të këtij aktiviteti në mjedis janë komponentët kryesore të këtij raporti.

Terreni në të cilin është ndërtuar objekti për prodhimin & perpunimin e detergjentëve të lëngshëm dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim dhe sapunit, dezinfektuesve për pastrim dhe prodhimi i pesticideve, është i rrafshët, dhe hapësira-lokaliteti, apo zona ku është realizuar projekti, nuk i përket asnjë zone të mbrojtur natyrore dhe nuk ka specie të rrezikuara, zona të rëndësishme historike apo kulturore në këtë zonë të cilat ndikohen nga zhvillimet e parashikuara në lidhje me aktivitetin e sipërpërmendur.

Raporti është punuar në bashkëpunim të ngushtë me pronarin, prej të cilit janë marrë të dhënat kryesore dhe të nevojshme përmes takimeve dhe bisedave.

Për hartimin e këtij raporti janë përdorur të dhëna nga përshkrimi teknik i projektit si dhe të dhëna dhe materiale për projekte të ngjashme, janë realizuar vizita në lokacionin e projektit dhe janë bërë fotografi.

Territori apo zona në studim nuk është e përfshirë në ndonjë zonë të mbrojtur, monument natyrore, park natyral, rezervat apo park kombëtar.

Nuk është zonë e përdorur për specie të natyrës (florë apo faunë), si për shumim, follenizim, ushqim, pushim, dimror apo migrim që mund të ndikohet nga zhvillimi i këtij aktiviteti.

Nuk është zonë me rëndësi historike apo kulturore dhe ka qasje direkte në rrugën kryesore Prishtinë – Lipjan - Ferizaj.

Funksionimi i kësaj fabrike paraqet ndikimin minimal në mjedis.

2. BAZA LIGJORE DHE INSTUTICIONALE

Për vlerësimin e ndikimit në mjedis — VNM-në është miratuar Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2023 me Nr. 08/L-181. Ky ligj përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM-së. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit të dëmeve dhe efekteve negative në mjedis.

Ligjet më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e VNM-së për veprimtarinë prodhimi i sapunit, detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për Vlerësimin e Ndikimeve në Mjedis Nr. 08/L-181
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji nr. 08/071 për ndyrshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Ligji nr. 08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanat administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative.
- Ligji Nr 2003/20 për pesticide
- Ligji Nr 03/L-042 I produkteve për mbrojtjen e bimeve
- Udhëzimi administrativ Nr. 13/2023 për katalogun shtetëror të mbeturinave

Për përgatitjen e këtij raporti janë shfrytëzuar ligjet dhe rregulloret ekzistuese të Republikës së Kosovës si dhe rregullat relevante.

3. METODOLOGJIA E PUNËS

Për të vlerësuar ndikimin në mjedis (VNM) si dhe për të identifikuar masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, për UBT SH.P.K, objektin egzistues në parcelën P-71409036-00164-28 në zonën kadastrale Konjuh-Komuna Lipjan, është ndjekur qasja e vlerësimit të përgjithshëm të projekteve të kësaj natyrë, si dhe është bërë analiza dhe identifikimi i ndikimeve të mundshme sipas fazave.

Informatat themelore mbi:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis,
- Popullatën dhe vendbanimet në lokacion,
- Karakteristikat hidrologjike, topografia dhe peizazhi në lokacionin e projektit,
- Kualiteti i ajrit, ujit dhe komponentëve tjerë mjedisor në lokacion,
- Bota bimore dhe shtazore në lokacionin e projektit.

Vlerësimi i ndikimeve sipas kriterëve në vijim:

- Gjendja e mjedisit në lokacionin e projektit,
- Lloji dhe madhësia e pritshme e ndotjes nga projekti,
- Karakteristikat dhe përbërja e materialit ndotës,
- Vlerësimi i përhapjes së ndotjes.

Përcaktimi i masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, duke u bazuar në rezultatet/ të gjeturat nga vlerësimi i ndikimeve në mjedis, në lokacionin e projektit

4. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROJEKTIT DHE KUSHTEVE MJEDISORE

Pozita gjeografike e lokacionit

Lokacioni i objektit gjendet në komunën e Lipjanit në rrugën Rr. Ibrahim Rugova, nr. P.n., në objektin egzistues në parcelën P-71409036-00164-28 në zonën kadastrale Konjuh – Komuna Lipjan.




Figure 1 Pamje satelitore të lokacionit të Fabrikës

Komuna e Lipjanit ka pozitë të përshtatshme gjeografike, sepse gjendet në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës dhe në udhëkryqin e rrugëve më të rëndësishme të rajonit. Territori administrativ i komunës është i pozicionuar në jug të Prishtinës, dhe mbulon sipërfaqen prej **338.54 km²**. Dendësia e popullsisë 170 b/km², e përafërt me mesataren e popullsisë në shkallë vendi 159.31b/km², 3.2% e territorit të shtetit. Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, numri i përgjithshëm i banorëve në Komunën e Lipjanit është **57.605** banorë.

Qyteti i Lipjanit është i pozicionuar në udhëkryqin në mes të dy rrugëve të rëndësishme 25/E 752 dhe 2/E 65, dhe të hekurudhës kryesore Mitrovicë-Shkup. Në jug një rrugë e rëndësishme e përshkon qytetin. Me këtë, qyteti është i pajisur mirë me infrastrukturë rrugore. Që prej se rruga 25/E 752 u anashkalu problemet e trafikut të dendur janë zvogëluar.

Komuna paraqitet në ndarje të tërthortë në rrafsh të Fushë Kosovës e rrafshlartat e Blinajës, Caralevës dhe Drenicës në perëndim dhe rrafshlarta e rrafshit të Androvackës në lindje. Lugina e Drenicës kalon nëpërmes të pjesës perëndimore të komunës (zona përreth Shalës). Kjo zonë ka lidhje më të afërt hapsinore me Gllogovcin. Qyteti i Lipjanit shtrihet në mes të rrafshit të Fushë Kosovës në një lartësi përafërsisht rreth 550 m. Majet më të larta në lindje dhe perëndim së bashku arrijnë mbi 1000m.

Lumi kryesorë i komunës është Sitnica, që rrjedh në drejtim jug-veri përmes të rrafshit. Në të derdhen disa lumenj të vegjël dhe procka, burimi i të cilave është në mallet përreth. Më të rëndësishmet janë lumi Janjevka, Zegorka dhe Gadimja.




Figure 2 Pozita gjeografike e komunës së Lipjanit

Popullsia

Popullsia dhe karakteristikat e saj kanë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e territorit në përgjithësi. Bazuar në shënimet statistikore të vitit 2024 (regjistrimi i popullsisë 2024 dhe regjistrimi+shtimi natyror) komuna e Lipjanit është **57.605** banorë.

Në qytetin e Lipjanit jetojnë rreth 6870 banorë, ndërsa pjesa tjetër jetojnë në zonat rurale (fshatra). Territori administrativ i komunës është i pozicionuar në jug të Prishtinës, dhe mbulon sipërfaqen prej 338.54 km². Dendësia e popullsisë 170 b/km², e përafërt me mesataren e popullsisë në shkallë vendi 205 b/km², 3.2% e teritorit të shtetit. Pjesa më e madhe e popullsisë janë shqiptarë (89 %), ndërsa (6 %) janë serb, kroatë (1 %), romë (1%) dhe 2.9% të tjerë. Mosha e popullsisë është e re, nga kjo rreth 40% janë të moshës 0-14 vjeç, 45% janë të moshës 15-65 vjeç dhe 15% janë të moshës mbi 65 vjeç. Mesatarja e madhësisë së familjeve është pesë anëtarë.

Është vlerësuar se në zonën ku ndodhet fabrika nuk janë prezente struktura banimi.




Figure 3 Komuna e Lipjanit në hartën e Kosovës

Topografia

Topografia e Komunës së **Lipjanit** është kryesisht **fushore**, me disa zona kodrinore dhe një reliev të butë që e bën këtë komunë të përshtatshme për bujqësi dhe zhvillim urban. Më poshtë janë detajet kryesore:

- Komuna e Lipjanit ndodhet në pjesën qendrore të Kosovës, në jug të Prishtinës.
- Shtrihet në një pjesë të **Rrafshit të Kosovës**, që është një fushë aluvionale e gjerë me tokë pjellore.
- Lartësia mesatare mbidetare është rreth **500 metra**.
- Pjesa më e madhe e territorit përbëhet nga **tokë e rrafshët ose pak e valëzuar**, me disa kodra të ulëta në periferi.

Fusha e Kosovës dominon në pjesën veriore dhe perëndimore të komunës.

- Në jug dhe jugperëndim ka disa zona **kodrinore**, të cilat nuk janë të theksuara dhe shërbejnë kryesisht për kullota dhe pyje të rralla.
- Rrjeti hidrografik përfshin lumenj të vegjël dhe përrenj sezonal, si **Lumi Sitnica**, që ndikon në formësimin e peizazhit dhe bujqësisë.

Biodiversiteti

Komuna e Lipjanit ka një shtrirje mjaft të madhe gjeografike e cila cila përfshin zonat mesatarisht të larta dhe zonat e ulëta të terrenit. Në këtë komunë sa i përket fitodiversitetit i lidhur me llojet e bimëve drunore shkon deri te brezi i ahishteve (*Fagus silvatica*) të përziera me bungë (*Quercus petraea*), ndërkaq në zonat e ulëta kemi vegjetacionin e livadheve me shoqime mjaft të mdha dhe të begatshme me lloje. Poashut në këto zona e gjejmë edhe vegjetacionin ruderal përgjat rrugëve dhe vendbanimeve por edhe barojat e kqia të cilat gjenden në tokat djerrina, në kufi të parcelave dhe në afërsi të gjerdheve. Sa i përket Zoodiversitetit kjo komunë me fshatrat që e tangjentojnë këtë komunë janë të pasura me llojllojshmëri të mjaftueshme shtazore, këtu vlenë të përmendet Rezervati Natyrorë Blinaja.

Prezenca e shumë shtazëve të egra, si dreri, kaprolli, derri i egër, mufloni, macja e egër, lepur, ujku, dhelpra etj., si dhe shumë shpezë, e bëjnë këtë vend atraktiv. Vetë kushtet natyrore në Blinajë mundësojnë një regjenerim të botës bimore dhe shtazore mjaft të përshtatshëm dhe mundësi për një rezervat gjuetie dhe rekreacion për shumë vizitorë.

- Pas hulumtimeve të bëra në fitodiversitetin e komunës së Lipjanit, parashikohet që disa lloje të mbrohen, ruhen dhe konservohen pasi që është konstatuar se ekzistojnë fitocenoza të cilat janë mjaft të begatshme dhe interesante në aspektin ekonomik, shkencor dhe mjekësor.
- Sa i përket zoodiversitetit, sipas të dhënave nga IKMN9, dhe analizave të ekipit punues territori i komunës së Lipjanit është i pasur me kafshë të egra, vlenë të veçohet Rezervati Blinaja dhe zona të tjera në mesin e të cilave ka edhe lloje që konsiderohen si të rrezikuara dhe në këtë drejtim, parashikohet mbrojtja e zonave ku jetojnë dhe veprojnë këto kafshë, dhe bimë si dhe mbrojtja e tyre si specie.
- Në fushën e biodiversitetit, parashihen projekte të përbashkëta me komunat tjera.
- Parashihet inventarizimi i florës dhe faunës në gjithë territorin e komunës, duke specifikuar çka duhet të mbrohet dhe çka mundë shfrytëzohet.
- Parashikohet një rezervat për ruajtjen e kaprollit (*Capreolus capreolus*), ujkut (*Canis lupus*), dhelprës (*Vulpes vulpes*), arealet e të cilave janë mjaft të rrezikuara.
- Parashikohet revitalizimi i ekosistemeve pyjore për parandalimin e shkatërrimit të habitateve të shumë llojeve bimore dhe shtazore, në territorin e komunës së Lipjanit. Duke e konsideruar të rëndësishme edhe ruajtjen e habitateve të fluturave, shpezëve mishngrënës etj.




Figure 4 Harta e vlerave të llogariturave të biodiversitetit

Ajri

Ajri i pastër është i rëndësishëm për shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve. Megjithatë, zhvillimi i hovshëm dhe i pakontrolluar ekonomik, vecanërisht në sektorin industrial dhe të trafikut ka ndikuar negativisht në cilësinë e ajrit dhe mjedisit në përgjithësi, si rezultat i shpërndarjes së ndryshme të substancave të ndotura në ajër, ujë dhe tokë. Qyteti i Lipjanit përballon një numër të madh makinash që qarkullojnë nëpër rrugë cdo ditë. Mungesa e hapësirave të majftueshme për parkim, makinat e vjetra dhe trafiku i dendur kanë shkaktuar ndojte të ajrit dhe kanë pasojë të dëmshme në shëndetin e banorëve. Një burim tjetër i ndotjes së ajrit është edhe ngrohja e shtëpive apo banesave kolektive gjatë sezonit të dimrit të cilat nuk janë të lidhura me ngrohjen e qytetit e sidomos përdorimi i thëngjillit apo lëndëve tjera djegëse.

Përdorimi i burimeve alternative të energjisë, si panelet diellore dhe burimet tjera të energjisë, ka pottencial për të përmirësuar cilësinë e ajrit në qytet. Megjithatë, ky trend po zhvillohet ngadalë. Institucioni i mandatuar për monitorimin e cilësisë së ajrit në Kosovë është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes Institutit Hidro-Meteorologjik të Kosovës (IHMK). Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit Nr.03/L-025, Ligjit i mbrojtjes së ajrit nga ndotja Nr.08/L-025 dhe Ligjit për veprimtarinë hidrometeorologjike Nr.06/L-035 IHMK është i obliguar që të bëjë monitorimin e cilësisë së ajrit në tërë territorin e Kosovës. Në Lipjan, cilësia e ajrit monitorohet në kohë reale nga stacioni i vendosur në **Shkollën e Mesme "Ulpiana"**, duke ofruar të dhëna të detajuara për ndotësit kryesorë

Cilësia e ajrit në Komunën e Lipjanit aktualisht vlerësohet si **e pranueshme (Fair)**, me një Indeks të Cilësisë së Ajrit (AQI) rreth **43**, sipas të dhënave të fundit nga AccuWeather dhe Plume Labs.

Të dhënat aktuale të ndotësve kryesorë:

- **PM2.5** (grimca të imta): 12 $\mu\text{g}/\text{m}^3$
- **PM10** (grimca të mëdha): 18 $\mu\text{g}/\text{m}^3$
- **NO₂** (dioksid azoti): 9 $\mu\text{g}/\text{m}^3$
- **O₃** (ozon në nivelin e tokës): 57 $\mu\text{g}/\text{m}^3$
- **SO₂** (dioksid squfuri): 7 $\mu\text{g}/\text{m}^3$
- **CO** (monoksid karboni): 197 $\mu\text{g}/\text{m}^3$

Megjithëse cilësia e ajrit është e pranueshme për shumicën e popullsisë, personat me ndjeshmëri të veçantë, si ata me sëmundje respiratore, mund të përjetojnë simptoma të lehta me ekspozim të zgjatur.



Figure 5 Harta e cilësisë së ajrit Komuna e Lipjanit

Resurset ujore

Burimet ujore të Komunës së Lipjanit luajnë një rol të rëndësishëm për jetën e përditshme të banorëve, bujqësinë dhe zhvillimin industrial. Komuna gjendet në pjesën qendrore të Kosovës dhe përshkohet nga lumi Sitnica, i cili është një nga rrjedhat më të gjata në vend dhe formon pjesën kryesore të rrjetit hidrografik të territorit. Përveç Sitnicës, përroje më të vogla si përroi i Gadimes dhe disa kanale kulluese kontribuojnë në ujitjen e sipërfaqeve bujqësore, sidomos gjatë muajve të thatë.

Sipas të dhënave të fundit, një pjesë e konsiderueshme e territorit të komunës ka ndjeshmëri mesatare deri të lartë për ujërat nëntokësore, gjë që e bën të domosdoshëm monitorimin dhe mbrojtjen e tyre nga ndotja. Furnizimi me ujë të pijshëm realizohet përmes ujësjellësit rajonal “Prishtina”, i cili mbulon shumicën e vendbanimeve urbane dhe një pjesë të fshatrave, megjithatë një pjesë e banorëve ende përdorin puse individuale apo burime lokale për nevoja shtëpiake.

Një nga sfidat kryesore mbetet kanalizimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura. Shumë vendbanime, veçanërisht në zonat rurale, nuk kanë sistem të plotë të kanalizimit dhe ujërat e zeza derdhen drejtpërdrejt në përroje apo kanale të hapura, duke rritur rrezikun për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Në aspektin bujqësor, burimet ujore janë jetike për ujitjen, pasi një pjesë e konsiderueshme e tokave bujqësore në Lipjan mbështetet në përroje, kanale kulluese dhe puse të vogla. Mungesa e një sistemi të organizuar për ujitje mbetet një kufizim, sidomos gjatë periudhave me reshje të pakta.

Në vitet e fundit, Komuna e Lipjanit ka ndërmarrë hapa për të përmirësuar infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe për të ndërgjegjësuar komunitetin për rëndësinë e mbrojtjes së lumenjve dhe burimeve ujore. Megjithatë, nevojiten investime të mëtejshme për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me ujë të pastër dhe për të trajtuar plotësisht ujërat e ndotura para derdhjes së tyre në mjedis.

Kjo përmbledhje paraqet lumenjtë, përrojet, kanalet kulluese dhe burimet nëntokësore që ndikojnë në territorin e komunës, së bashku me gjendjen aktuale dhe përdorimin e tyre.

Nr.	Lloji i burimit	Emri i burimit	Përshkrimi	Zona që mbulon	Problemet kryesore	Përdorimi
1	Lumi	Sitnica	Lumi kryesor që përshkon territorin	Qendra e komunës dhe fshatra përreth	Ndotja nga ujërat e zeza dhe mbeturinat	Bujqësi, kullim
2	Përroi	Përroi i Gadimes	Përroi lokal	Gadime, fshatra përreth	Shkarkime të pa trajtuara	Ujitje tokash
3	Kanale kulluese	Kanale të ndryshme	Kanale artificiale për ujitje	Toka bujqësore	Bllokime, mungesë mirëmbajtjeje	Ujitje
4	Burime nëntokësore	Puse individuale	Puse private dhe komunitare	Zona rurale	Ndotja nga aktivitetet bujqësore	Ujë i pijshëm
5	Ujësjiellësi rajonal	Rrjeti "Prishtina"	Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm	Qendra dhe disa fshatra	Humbje teknike, rrjet i vjetruar	Ujë i pijshëm

Harta skematike e resurseve ujore - Komuna e Lipjanit




Figure 6. Harta skematike e resurseve ujore

Infrastruktura ekzistuese

Komuna e Lipjanit ka një infrastrukturë rrugore të zhvilluar që mbulon pothuajse të gjithë territorin e saj. Ajo ka një pozitë të favorshme gjeografike, duke u shtrirë afër kryeqytetit Prishtinë dhe duke pasur lidhje të drejtpërdrejta me qytetet përreth përmes rrugëve magjistrale dhe rajonale. Lipjani ndodhet përgjatë rrugës magjistrale M2, e cila e lidh me Prishtinën në veri dhe me Ferizajn e Shkupin në jug. Lidhja më e afërt me autostradën Prishtinë–Shkup realizohet përmes daljes në Babush, që ndodhet rreth 10 km larg qendrës së qytetit.

Komuna ka qasje të drejtpërdrejtë në rrjetin hekurudhor të Kosovës përmes linjës Prishtinë–Hani i Elezit, e cila kalon përmes territorit të saj dhe ofron mundësi për transport të mallrave dhe udhëtarëve. Rrjeti rrugor lokal është i zgjeruar, duke lidhur qendrën urbane me fshatrat përreth dhe zonat industriale.

Infrastruktura energjetike është e integruar në rrjetin kombëtar, me linja të tensionit të mesëm dhe të lartë, ndërsa zonat industriale dhe projektet e reja, përfshirë kapacitetet e mundshme për energji të ripërtëritshme, kanë qasje të lehtë në rrugët publike dhe në rrjetin elektrik ekzistues.

Efektet vizuale (peizazhi)

Peizazhi i Komunës së Lipjanit përfaqëson një ndërthurje harmonike të elementeve natyrore dhe atyre të krijuara nga dora e njeriut, duke krijuar një pamje të qetë, të hapur dhe tërheqëse për banorët dhe vizitorët. Fushat e gjera që shtrihen në këtë territor janë ndër pasuritë kryesore natyrore, të cilat formojnë një horizont të hapur që në stinët e ndryshme ofron kontraste të pasura ngjyrash, nga gjelbra e pranverës deri tek ngjyrat e ngrohta të vjeshtës.

Kodrat e ulëta që ndodhen në disa pjesë të komunës i japin peizazhit një dinamikë të butë dhe krijojnë efekte vizuale që thyejnë monotoninë e fushës, duke ofruar pika vëzhgimi natyrale për të parë përreth. Rrjedhat e lumenjve të vegjël, si lumi Sitnica, kontribuojnë në freskinë vizuale të peizazhit dhe krijojnë korridore natyrore të gjelbra që janë të rëndësishme për biodiversitetin.

Në zonat rurale, shtëpitë tradicionale me oborre të gjelbra, kopshte dhe pemishte e pasurojnë peizazhin me elemente të trashëgimisë kulturore dhe identitetit lokal.

Ndërkohë, në qendrat urbane po ndërtohen rrugë, sheshe dhe hapësira publike që duhet të harmonizohen me peizazhin natyror për të ruajtur një pamje të këndshme vizuale dhe për të ofruar hapësira rekreative për komunitetin.

Për projekte të reja, ruajtja dhe integrimi i elementeve natyrore në planifikimin urban është thelbësor për të mos humbur karakterin e veçantë të Lipjanit. Zhvillimi i parqeve, gjelbërimi urban dhe kujdesi për tokat bujqësore janë disa nga faktorët që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë vizuale të komunës.

Ky peizazh i pasur dhe i balancuar ka potencial të madh për zhvillim të qëndrueshëm, turizëm rural dhe rekreacion, duke i dhënë Lipjanit një identitet unik brenda hartës së Kosovës.

Zhurma

Në Komunën e Lipjanit, burimi kryesor i zhurmës është trafiku rrugor, për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë të komunës me rrugët magjistrale dhe autostradën që kalon afër territorit të saj. Trafiku i rënduar, sidomos përgjatë rrugëve që lidhin Lipjanin me Prishtinën dhe Ferizajn, krijon nivele të ndjeshme zhurme në zonat urbane dhe përgjatë akseve kryesore rrugore.

Industria në Lipjan është e përqendruar kryesisht në zona të caktuara industriale dhe në periferi të qytetit, duke gjeneruar burime të tjera zhurme përmes aktivitetit të makinave të rënda, magazinimit dhe përpunimit industrial. Aktivitetet ndërtimore, të cilat janë të pranishme gjatë periudhave të caktuara të vitit, ndikojnë gjithashtu në rritjen e nivelit të zhurmës, veçanërisht në zonat urbane dhe ato të zhvillimit të ri.

Në disa raste, zhurma mund të shkaktohet edhe nga aktivitete bujqësore, sidomos gjatë sezonit të korrigjësive dhe punimeve me makineri bujqësore në zonat përreth vendbanimeve.

Në përgjithësi, zhurma e krijuar nga faktorë të ndryshëm, përfshirë mungesën e planeve të kontrollit të zhurmës, ndikon në cilësinë e jetës së banorëve dhe mund të ketë ndikim negativ në shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Për këtë arsye, menaxhimi dhe monitorimi i burimeve të zhurmës mbetet një aspekt i rëndësishëm për Komunën e Lipjanit.

5. PËRSHKRIMI I PROCESIT TEKNIK

Objekti i fabrikës gjendet në zonën kadastrale Konjuh – Komuna Lipjan me numër të njësisë kadastrale P-71409036-00164-28, lloji i njësisë është ndërtesë multifunksionale me sipërfaqe të përgjithshme prej 780 m².

Për funksionimin e fabrikës për prodhimin dhe përpunimin e detergjentëve të lëngshëm, siç janë detergjenti për enë, detergjenti për rroba, shampo, si dhe produkteve të pastrimit, preparateve për shkëlqim, sapunëve, dezinfektuesve, antiseptikëve dhe pesticideve përdoren këto makineri:

Faza I: Sistemi i ujit të destiluar

Faza II: Rezervuarët ku prodhohen produktet

Faza III: Makinë mbushese me nozull

6. PËRSHKRIMI I PROCESIT TEKNOLOGJIK, PAJIMET

Përshkrimi dhe karakteristikat kryesore të procesit të prodhimit

Objekti i fabrikës gjendet në zonën kadastrale Konjuh – Komuna Lipjan me numër të njësisë kadastrale P-71409036-00164-28, lloji i njësisë është ndërtesë multifunksionale me sipërfaqe të përgjithshme prej 780 m².

Për funksionimin e fabrikës për prodhimin dhe përpunimin e detergjentëve të lëngshëm dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim dhe sapunit, dezinfektuesve për pastrim dhe prodhimin e pesticideve përdoren këto makineri:


Procesi i prodhimit në fabrikën për prodhimin e detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, kalon nëpër këto faza:

Faza I: Sistemi i ujit të destiluar

Faza II: Rezervuarët ku prodhohen produktet

Faza III: Makinë mbushese me nozull

Faza I: Sistemi i ujit te destiluar



Ky sistem është projektuar për të përpunuar ujin që vjen nga rrjeti i jashtëm i ujësjellësit dhe për ta

transformuar në ujë të distiluar me cilësi të lartë, i domosdoshëm për përdorim industrial ose prodhim (p.sh. në prodhimin e detergjenteve dhe sapunëve).

1. Rezervuari i ujit nga rrjeti i ujësjellësit

- Uji fillimisht merret nga rrjeti publik i ujësjellësit dhe depozitohet në një rezervuar, ku sigurohet që të ketë një sasi të qëndrueshme për përpunim.

2. Hidropori (Pompa)

- Nga rezervuari, uji shtyhet përmes një hidropori (pompe me presion) për të krijuar presionin e nevojshëm për fazat e mëtejshme të trajtimit.

3. Sistemi i larësit të karbonit dhe zbutësit

- Uji kalon në një larës të karbonit aktiv, ku filtrohen substancat organike, klori dhe komponimet e tjera të dëmshme.
- Më pas kalon në zbutësin, i cili heq jonet e forta të kalciumit dhe magnezit (për të parandaluar formimin e gurëve të ujit dhe për të zgjatur jetën e pajisjeve).

4. Zbutësit (filtrat e zbutjes)

- Zbutësit përfshijnë një seri të filtrave me jon-shkëmbim, që largojnë mineralet e forta duke i zëvendësuar me jone natriumi.

5. Sistemi i Osmosës Inverse (Sistemi Osmor)

- Uji i zbutur pastaj kalon nëpër sistemin e osmosës inverse, ku membranat gjysmë-permeabile heqin deri në 99% të kripërave të tretura, baktereve dhe papastërtive mikroskopike.

6. Deionizatori (DE-IONIZATOR)

- Si fazë finale, uji kalon në një deionizator, ku përmes rrëshirave për shkëmbim jonik largohen plotësisht jonet e mbetura (si ato të natriumit, klorurit, sulfatesh etj.). Kjo siguron që uji të ketë përçueshmëri shumë të ulët — tipike për ujë të distiluar me pastërti të lartë.

7. Uji i distiluar përfundimtar

- Në fund të procesit, uji është i pastër, pa jone, pa papastërti organike dhe i gatshëm për përdorim në procesin industrial ose në aplikime që kërkojnë ujë me pastërti të lartë.

Përmbledhje:

Ky sistem siguron një proces të plotë filtrimi mekanik, kimik dhe fizik, duke e transformuar ujin e zakonshëm të rrjetit në ujë të distiluar, të përshtatshëm për përdorim në prodhim, laboratorë ose industrinë e kimikateve.

Faza II: Rezervuarët ku prodhohen produktet



Përshkrimi i procesit në këtë figurë tregon mënyrën se si rezervuarët përdoren për përzierjen dhe prodhimin e produkteve (p.sh. detergjentë, sapunë të lëngshëm ose produkte për pastrim).

1. Paneli i kontrollit (makineria automatike)

Në fillim, procesi kontrollohet përmes një paneli elektronik, i cili rregullon të gjithë parametrat e

nevojshëm: kohën e përzierjes, temperaturën, shpejtësinë e përzierjes dhe rrjedhjen.

2. Rezervuari i parë (500 kg)

Lënda e parë dhe uji i distiluar futen në rezervuarin e parë, i cili ka një kapacitet prej 500 kg. Në këtë rezervuar bëhet përzierja fillestare — ku përmes mikserëve të brendshëm, komponentët homogjenizohen. Këtu mund të shtohen edhe aditivë, ngjyra ose aromat sipas formulës.

3. Rezervuari i dytë (1000 kg)

Pasi faza e parë të përfundojë, përzierja transferohet ose plotësohet në rezervuarin e dytë, me kapacitet më të madh (1000 kg). Këtu vazhdon procesi i përzierjes dhe stabilizimit të produktit deri në arritjen e cilësisë finale. Ky hap siguron homogjenitet të plotë të përzierjes para se produkti të kalojë në fazën e mbushjes dhe paketimit.

Si përfundon procesi?


- Pas përzierjes, produkti transferohet në makinat e mbushjes, ku ambalazhohet sipas specifikave.
- Kjo rrjedhë siguron efikasitet dhe sasi të madhe prodhimi, duke minimizuar humbjet dhe rritur kontrollin e cilësisë.

Sasia e ambalazhes e paraqitur në tabelë:


- | Nr. | Sasia e ambalazhës |
|-----|--------------------|
| 1 | 500 ml |
| 2 | 1 litër |
| 3 | 3 litra |
| 4 | 4 litra |
| 5 | 10 litra |

Skema e Procesit Teknologjik





Skema e mbushjes



7. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Përveç ndikimeve pozitive ekonomike që vijnë nga aktivitetet dhe funksionalizimi i fabrikës së kompanisë UBT SHPK në Konjuh, Komuna e Lipjanit, kjo fabrikë jep një kontribut të madh në përpunimin dhe prodhimin e shampoos dhe produkteve të kujdesit personal, duke përfshirë preparate të ndryshme për larje dhe mirëmbajtje higjienike. Ndikimet në mjedis paraqiten kur vepron faktori antropogjen në zonë, megjithatë këto ndikime janë të kufizuara dhe kontrollohen në përputhje me standardet mjedisore, duke filluar nga minimumi real i këtij ndikimi.

Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të detajuar të ndikimeve që mund të shfaqen gjatë funksionimit të fabrikës, duke specifikuar edhe masat zbutëse që do të zbatohen për të eliminuar ose minimizuar këto ndikime. Analiza e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) realizohet duke u bazuar në projektin ideor të konceptuar dhe të diskutuar më lart në këtë raport, si dhe nga gjendja reale në lokacionin konkret, respektivisht në zonën ku operon fabrika në Konjuh. Kjo analizë synon të vlerësojë ndikimet në mjedis në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, duke mos cënuar aspektet: kimike-fizike (ndikimi në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferën) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme ose të përhershme, pozitive ose negative).

Në objektin e fabrikës UBT SHPK në Konjuh, mbetjet janë minimale, pasi produktet që nuk përmbushin standardet futen sërish në procesin e ripërpunimit, duke evituar krijimin e mbetjeve të panevojshme gjatë ciklit të prodhimit.

Më poshtë paraqitet analiza për secilin faktor mjedisor, së bashku me masat zbutëse përkatëse që do të ndërmerren për të siguruar që ndikimi mjedisor të jetë minimal dhe i kontrolluar.

Ndikimet në Ajër

Në lokacionin ku është ndërtuar fabrika për prodhimin e shampoos dhe produkteve të kujdesit personal të kompanisë UBT SHPK, në fshatin Konjuh, Komuna e Lipjanit, nuk parashikohet të ketë ndonjë ndikim të konsiderueshëm në cilësinë e ajrit për zonën e Konjuhut, qytetin e Lipjanit dhe vendbanimet përreth. Në përgjithësi, ndikimet e mundshme në cilësinë e ajrit lidhen kryesisht me lëvizjen e automjeteve transportuese, të cilat mund të shkaktojnë ngritjen e një sasive të vogël grimcash pluhuri gjatë ngarkim-shkarkimit të lëndëve të para apo gjatë shpërndarjes së produkteve të gatshme.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se procesi teknologjik i prodhimit të shampoos nuk përfshin aktivitete që lëshojnë gazra ndotës ose emisione të dëmshme në atmosferë. Të gjitha proceset e përzierjes dhe paketimit realizohen në ambiente të mbyllura, duke minimizuar plotësisht mundësinë e lirim të substancave ndotëse.

Prandaj, ndikimi negativ në cilësinë e ajrit parashikohet të jetë minimal, duke kontribuar në ruajtjen e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm për banorët e Konjuhut dhe komunës së Lipjanit. Përveç kësaj, kompania UBT SHPK do të zbatojë masa organizative për mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme, kontrollin e pluhurit dhe inspektimin periodik të automjeteve transportuese, në mënyrë që çdo ndikim i mundshëm të jetë nën kontroll dhe në Ndikimet në ujë.

Objekti i prodhimit nuk ndodhet në afërsi të ndonjë burimi ujor të ndjeshëm apo në zonë të mbrojtur me rëndësi hidrologjike. Megjithatë, përpunimi i detergjentëve, sapunëve dhe preparateve për pastrim mund të ketë ndikim të drejtpërdrejt ose të tërthortë në cilësinë e ujërave nëse nuk menaxhohet në mënyrë të duhur. Rreziqet përfshijnë:

- Derdhjet e mundshme aksidentale të substancave kimike gjatë prodhimit apo transportit.
- Përdorimi i ujit në procesin teknologjik dhe mundësia e shkarkimeve industriale në rrjetin publik apo mjedis.

Rekomandim: Të aplikohet një sistem trajtimi paraprak të ujërave të ndotura para shkarkimit dhe të sigurohet që të gjitha standardet e përcaktuara në Ligjin për Ujërat e Kosovës (Nr. 04/L-147) dhe aktet nënligjore të zbatohen në praktikë.

Ndikimet në tokë

Ndikimet potenciale në tokë lidhen me:

- Derdhjet e kimikateve dhe absorbimi i tyre nga dheu.
- Shpërndarja e mbetjeve të ngurta që mund të kontaminojnë shtresat e sipërme të tokës.
- Rreziku nga akumulimi afatgjatë i substancave të rrezikshme që mund të ndikojnë në strukturën dhe pjellorinë e tokës.

Duke qenë se zona është jashtë zonave të mbrojtura dhe është karakterizuar si terren i rrafshët dhe jo i përdorur për bujqësi intensive, ndikimi i menjëhershëm mund të jetë i kufizuar, por rreziqet afatgjata ekzistojnë në mungesë të menaxhimit të mirë të substancave të rrezikshme.

Rekomandim: Zbatimi i masave parandaluese për përhapjen e ndotjes në tokë dhe trajnimi i stafit për

menaxhimin e sigurt të lëndëve kimike.

Ndikimet në florë dhe faunë

Zona nuk përfshin specie të mbrojtura dhe nuk ka habitate natyrore me rëndësi të veçantë. Megjithatë, duke marrë parasysh afërsinë me zona më të gjera natyrore në komunë (si Rezervati Natyror i Blinajës), ndikimet sekondare si:

- Shpërndarja e ndotësve përmes ajrit, ujit apo tokës.
- Niveli i zhurmës apo ndriçimi artificial.

mund të krijojnë stres ekologjik për lloje të caktuara të faunës, veçanërisht shpezët dhe gjitarët e vegjël.

Rekomandim: Të ruhet monitorimi i vazhdueshëm për ndikimet sekondare dhe të ndërmerren masa mbrojtëse për të ruajtur biodiversitetin lokal.

Trajtimi dhe deponimi i mbeturinave

Veprimtaria industriale e kësaj fabrike prodhon mbetje të ndryshme si:

- Mbeturina të ngurta (ambalazhe plastike, letër, karton, mbetje të procesit).
- Mbetje të rrezikshme (mbetje kimike nga detergjentët dhe pastruesit).
- Mbetje të zakonshme komunale.

Raporti përmend përdorimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 13/2023 për katalogun shtetëror të mbeturinave, por nuk paraqet në detaje skemën e trajtimit të mbetjeve.

Rekomandim: Të sigurohet ndarja selektive e mbeturinave në vendin e gjenerimit, klasifikimi i mbeturinave të rrezikshme, sigurimi i licencave për transportues të certifikuar dhe deponimi vetëm në pika të autorizuara.

Zhurma

Prodhimi industrial, edhe kur kryhet në objekte të mbyllura, është i lidhur me krijimin e niveleve të zhurmës mbi sfondin natyror. Në këtë rast:

- Zona është jashtë zonave të banuara, çka ul ndikimin në komunitet.
- Nuk ka prezencë të ndjeshme të strukturave banimi në afërsi të projektit.
- Megjithatë, ndikimi në personelin e brendshëm dhe në punëtorët e angazhuar duhet të merret në konsideratë.

Rekomandim: Të bëhet monitorim periodik i nivelit të zhurmës sipas standardeve të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen nga Zhurma (Nr. 02/L-102) dhe të vendosen masa teknike (pajisje që reduktojnë zhurmën, orare pune të kufizuara për proceset më zhurmuese).

8. PËSHKRIMI I MASAVE PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

Përshkrimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis për fabrikën për prodhimin dhe punimin e detergjentëve të lëngshëm dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim dhe sapunit, dezinfektuesve për pastrim dhe prodhimin e pesticideve në Komunën e Lipjanit është një komponent thelbësor i menaxhimit të qëndrueshëm të mjedisit dhe përgjegjësisë shoqërore të ndërmarrjes. Implementimi i këtyre masave është i detyrueshëm për të minimizuar ndikimet potencialisht të dëmshme që mund të shkaktohen nga procesi i prodhimit, ruajtja dhe shpërndarja e produkteve kimike.

Për zbatimin korrekt të këtyre masave, përgjegjësia bie mbi pronarin dhe menaxhmentin e fabrikës, ndërsa mbikëqyrja dhe kontrolli i zbatimit të tyre bëhet nga inspektorët komunalë për mjedis të Komunës së Lipjanit.

Masat për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis janë paraqitur në tabelën përkatëse më poshtë. Përveç masave specifike, duhet të zbatohen edhe masa të përgjithshme të përshkruara më poshtë:

- **Riciklimi i mbeturinave:** Krijimi i një sistemi të strukturuar për grumbullimin, ndarjen dhe riciklimin e mbeturinave që krijohen gjatë procesit të prodhimit, përfshirë mbeturinat e ambalazheve dhe të lëndës së parë.
- **Përdorimi i lëndës së parë më pak të dëmshme:** Përzgjedhja e lëndëve të para me ndikim më të ulët në mjedis dhe të certifikuara sipas standardeve për siguri mjedisore.
- **Përdorimi efikas i energjisë:** Investimi në pajisje dhe teknologji të efikase në konsum energjie, përdorimi i burimeve të energjisë së ripërtëritshme kur është e mundur dhe monitorimi i vazhdueshëm i konsumit të energjisë.
- **Transporti i qëndrueshëm:** Sigurimi që mjetet transportuese që përdoren për shpërndarjen e produkteve të jenë me emetime të ulëta, në përputhje me standardet mjedisore.
- **Sistemi i monitorimit të mjedisit:** Instalimi i një sistemi të përhershëm për monitorimin e faktorëve mjedisorë (ajri, uji, toka), me raporte periodike që do të dorëzohen pranë autoriteteve komunale.

Në **Tabelën 1** janë paraqitur në mënyrë të detajuar masat specifike për mbrojtjen e mjedisit sipas faktorëve mjedisorë, si ajri, uji, toka dhe zhurma.

KOMPONENTA MJEDISORE	SHKALLA E NDIKIMIT	VEPRIMI QË SHKAKTON NDIKIMI NË MJEDIS	MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT
AJRI	Ndikim minimal	dotja e ajrit mund ndikohet nga: -Mos ajrosja e rregullt e objektit në të cilën operon fabrika për prodhimin e sapunëve dhe detergjenteve për shkëlqim; - Moskujdesi për hapësirën rreth objektit të fabrikës; -Pluhuri i liruar në mjedis gjatë ngasjes së makinave të cilët përdoren për transporin e produkteve që prodhohen nga fabrika.	Është e rëndësishme të kete një sistem të rregullt të ajrosjes se objektit. Ky proces do të sigurojë që ajri të qëndrojë i pastër dhe të freskët brenda objektit, duke ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së ajrit të brendshëm dhe në largimin e ndotësve potencialë. - Duhet të mirëmbahet dhe ujitet në mënyrë të vazhdueshme sipërfaqja e tokës ku operohet Ky veprim është i rëndësishëm për të parandaluar krijimin e pluhurit dhe për të ruajtur mjedisin lokal. -Pajisjet makinerike që përdorim për transportin duhet të mirëmbahen dhe të ruhen në mënyrë të rregullt. Është e rëndësishme të sigurojmë që këto pajisje të mos lëshojnë gazra të dëmshëm për mjedisin dhe cilësinë e ajrit.
UJI	Ndikim mesatar	Prodhimi i detergjenteve mund të përfshijë përdorimin e substancave kimike të dëmshme që shpërndahen në ujërat e ndotura.	Zgjedhja e substancave të bëhet në atë mënyrë që ndikimi në mjedis të jetë minimal ose zero; -Trajnimi i stafit të fabrikës në lidhje me

			rëndësinë e përdorimit të substancave të sigurta.
TOKA	Ndikim minimal	Derdhja aksidentale e detergjenteve në mejdis gjatë transportit	Mjetet transportuese të sigurohen në atë mënyrë që të evitohet aksidenti; -Kujdesi i stafit gjatë procesit të transportit të produktit të prodhuar.
BIODIVERSITETI	Ndikim minimal	Ndikimi në florën dhe faunën e zones përreth objekti të fabrikës.	Pasi në vendin e punimeve dhe në zonë në përgjithësi, nuk ka të dhëna për ndonjë lloj të rrallë, apo të pazakonshëm të florës apo faunës, ky ndikim është minimal, dhe pothuajse jo relevant.
PEISAZHI	Ndikim minimal	Ndryshimi i peizazhit lokal	-Për të ruajtur karakterin peizazhor e veçmas ndikimin të komuniteti, lokacioni i fabrikës të rrethohet me rrethoja përkatëse, dhe preferohet të rrethohet gardh natyror ose pisha dekorative.
MBETURINAT	Ndikim minimal	Mos menaxhimi i duhur i mbeturinave	Mbeturinat e gjeneruara nga aktivitetit i fabrikës të hudhen në kontejner për mbeturina; -Të mirëmbahen kontejnerët e mbeturinave;
ZHURMA	Ndikim minimal	Nuk ka gjenrim të zhurmës nga aktiviteti i fabrikës.	Në rast të shkaktimeve të zhurmës fabrika duhet të ndërmarrë hapa për të kontrolluar dhe kufizuar zhurmën që prodhohet gjatë operacioneve të saj. Kjo përfshin përdorimin e pajisjeve të izolimit të zhurmës dhe të ndërmarrë të tjera për të siguruar që zhurma e prodhuar të jetë brenda niveleve standarde të lejuara.

ZJARRI	Ndikim mesatar	Në rastë të ndonjë fatkeqësie natyrore apo të shkaktuar nga rrufeja, pakujdesia etj.	Vëndosja e rrjetit hidrant për shuarjen e zjarrit; -Pajisje për zjarrfikje të vendosen tek objekti, në vende të dukshme dhe me qasje të lehtë; -Punëtorët të trajnohen për përdorimin e tyre; - Investitori do të siguroj dhe mirëmban aparate adekuate për fikje të zjarrit në hapësirat me rrezik nga zjarri do të rrethohen dhe shënohen si dhe do të furnizoj aparate speciale për fikje të zjarrit, sipas nevojës; - Do të merren masta adekuate nga investitori për ruajtjen e popullatës lokale në rast të ndonjë fatkeqësi të shkaktuar nga zjarri;
SHËNDETI I POPULLATËS	Ndikim minimal	Ndikimet në popullatë nga: - Mbeturinat, - Ndotja e ujërave - Ndotja e tokës - Zhurma	Mbeturinat duhen larguar në mënyrë të rregullt; -Të parandalohet shkaktimi i zjarrit duke marrë parasysh të gjitha masat e duhura ligjore; -Të monitorohen dhe do të parandalohet ndotja e tokës dhe ujërave; - Zhurma e shkaktuar duhet të jetë brenda standardeve.

9. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi

Në bazë të gjendjes faktike në terren, ky aktivitet nuk paraqet trysni mjedisore.

Produktet dhe ndikimet në mjedis do të kontrollohen në mënyrë të rregullt dhe për çdo rast duhen të merren masat e nevojshme komfor ligjeve dhe të njoftohen organet kompetent.

Qëllimi i Monitorimit

Mbrojtja e ajrit, ujit, tokës, biodiversitetit dhe popullatës nga ndotja dhe aksidentet mjedisore.

Autoriteti përgjegjës

Komuna e Lipjanit / Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit/ Inspektoriati Mjedisor

Duhet të aplikohen metoda të inspektimit si më poshtë:

- Vizita të rregullta të cilat lajmërohen dhe inspektime të aty për atyshme.
- Ndikimi i objektit në mjedis të monitorohet dhe të mbikëqyret duke respektuar ligjet mjedisore në fuqi, dhe po ashtu komuna në rastin e shkaktimit të ndotjes duhet të kërkojë zbatimin e parimit “ndotësi paguan”.
- Për të minimizuar ndikimin në mjedis dhe në shëndetin publik duhet që ky aktivitete të monitorohet dhe të mbikëqyret.

10.PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E INFORMATAVE TË OFRUARA

Lokacionit i fabrikës për prodhimin&perpunimin e detergjentëve të lëngshëm dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim dhe sapunit, dezinfektuesve per pastrim dhe prodhimi i pesticideve, objektin egzistues në parcelën P-71409036-00164-28 në zonën kadastrale Konjuh – Komuna Lipjan. Objekti është një ndërtesë multifunksionale me sipërfaqe prej 780m2 dhe është përdorur për prodhimin e sapunëve dhe detergjenteve për shkëlqim. Për të arritur këtë, janë përdorur makineri të veçanta, duke filluar me systemin e ujit te destiluar po ashtu duke përfshirë një rezervuar për përzierje me kapacitet 1000 litra, makina për mbushje. Procesi i prodhimit kalon nëpër këto tre faza te rendesishme te cilat janë të specifikuara në mënyrë të detajuar për secilen faze të procesit të prodhimit. Pas përpunimit, mbetjet minimizohen, dhe përdorimi i lëndës së parë për ripërpunim është një praktikë e zakonshme. Ndikimet në mjedis janë vlerësuar në mënyrë të kujdesshme. Për shembull, ndikimi në ajër është minimal, pasi produkti përdor lëndë të pastër dhe nuk shkakton lirim të gazrave të dëmshëm në atmosferë. Ndikimi në ujë është i kujdesshëm për të parandaluar ndotjen e ujërave të zeza, dhe përdorimi i filtreve për pastrimin e ujit është bërë për të garantuar cilësinë e ujit. Masat për zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis përfshijnë riciklimin e mbeturinave, përzgjedhjen e lëndës së parë që ka ndikim më të ulët në mjedis, përdorimin e teknologjisë së energjisë së ripërtishme për të zvogëluar konsumin e energjisë, përdorimin e mjetëve transportues miqësor ndaj mjedisit, dhe vendosjen e një sistemi të vazhdueshëm të monitorimit të ndikimeve në mjedis. Ky raport i përmbledhur paraqet një përshkrim të hollësishëm të projektin, procesit të prodhimit, ndikimeve në mjedis, dhe masave për zvogëlimin e tyre, duke treguar përgjegjësinë dhe kujdesin e kompanisë për mjedisin dhe komunitetin lokal.

11.LITERATURA

- Draft Plani zhvillimor komunalë Lipjan 2013-2023
- Projekt harta zonale e komunës së Lipjanit 2021-2029
- Agjensia e statistikave të Kosovës
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, 2009/03-L-025.
- Ligji për Mbeturinat, 2005/02-L30.
- Ligji për Mbrojtjen e ajrit, 2004/30.
- Ligji për Mbrojtjen e bimëve, 2006/02-L95.
- Ligji për Mbrojtjen e natyrës, 2005/02-L18.
- Ligji për Mbrojtjen nga zhurma, 2007/02-L102.
- Rregullore (MPMS) NR. 02/2017 për mbrojtjen e të punësuarëve nga risqet lidhur me zhurmën në vendin e punës
- Udhëzimi administrativ Nr. 13/ 2023 për katalogun shtetëror të mbeturinave

12.SHTOJCA

Këtij plani bashkangjitur gjeni këto dokumente:

- ✓ Certifikatë e regjistrimit;
- ✓ Informata mbi biznesin;
- ✓ Pëlqimi komunal;
- ✓ Kopja e planit;
- ✓ Certifikata e tokës
- ✓ Certifikata e pronësisë me kopje plani
- ✓ Kontrat për qiranë e objektit (nese ka)
- ✓ Kontrata për mbeturina;
- ✓ Plani i rilevimit të terrenit (Gjeodet I licensum)
- ✓ CD e cila përfshin kopjen elektronike të këtij raportit.
- ✓ Licenca per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis.